



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

APS.nr.1/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi – kryetar, Kreshnik Radoniqi dhe Vaton Durguti – anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve **E.Q.**, **A.M.** dhe **R.GJ.**, të akuzuar secili veç e veç për vepër penale *keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.202/2018 të datës 21.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, me datë 15.04.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe sipas detyrës zyrtare, **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.202/2018 të datës 21.10.2019, dhe çështja kthehet në rigjykim dhe vendim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.202/2018 të datës 21.10.2019, të akuzuarit **E.Q.**, **A.M.** dhe **R.GJ.** janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale *keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 par. 1 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe të njëjtën ta kthej në rigjykim dhe vendim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale kanë parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit E.Q., avokat Elmi Qerimi, mbrojtësi i të akuzuarit A.M., avokat Artan Qerkini, dhe mbrojtësi i të akuzuarit R.GJ., avokat Teki Bokshi, me propozim që ankesa e Prokurorisë Speciale të refuzohet si e pabazuar.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.24/20 të datës 21.01.2020, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigjet në ankesë të parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit E.Q., avokat Elmi Qerimi, mbrojtësi i të akuzuarit A.M., avokat Artan Qerkini, dhe mbrojtësi i të akuzuarit R.GJ., avokat Teki Bokshi, të refuzohen si të pabazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykimin e ankimuar me të cilën të akuzuarit janë liruar nga aktakuza, palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet ankimore së bashku më shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Ankesa dhe Përgjigjet në Ankesë

Prokuroria në ankesën e saj pretendon se aktgjykimi i ankimuar është kundërthënës me arsyet e dhëna si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Sipas ankesës në aktgjykimin e ankimuar nuk kontestohen provat e lexuara, por ato nuk përfillen edhe pse vërtetojnë se të akuzuarit nuk kanë respektuar vendimin apo interpretimet e ARKEP-it, po ashtu as vendimet e gjykatës duke përfshirë edhe vendimin e arbitrazhit. Lidhur me këtë është e qartë se të akuzuarit këtë e kanë bërë me dashje duke pas parasysh se nga pozitat që i kishin, ishin të thirrur që të kuptojnë mos respektimin e vendimeve të autoritetit rregullativ e aq më tepër të Gjykatës. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk i ka marr parasysh kërkesat-njoftimet që janë shkëmbyer në mes PTK, ARKEP dhe Z..., deri në marrjen e vendimit të arbitrazhit e që kishin të bënin me ndarjen e numeracionit, dhe përkundër të gjitha kërkesave, numeracioni i është vonuar dhe për të gjitha këto të akuzuarit E.Q. dhe R.GJ. kanë qenë në dijeni. Po ashtu nga të akuzuarit janë injoruar edhe kërkesat e vazhdueshme për dhënien e shërbimeve të 3G dhe 4G, të cilat kërkesa i janë drejtuar edhe anëtarëve të bordit dhe Kryeshefit Ekzekutiv A.M., e ky injorim i të gjitha kërkesave ka rezultuar me procedurën e arbitrazhit që ka shkaktuar dëmin në shumë mbi 32 milion euro. Nga kjo shihet se të akuzuarit kanë vepruar me dashje dhe nuk qëndron konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk ka ekzistuar dashja e të akuzuarve për të kryer veprën penale. Konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se procedura e arbitrazhit kishte filluar para se i akuzuari A.M. të

merr pozitën e kryeshefit është vlerësim i gabuar për shkak se procedura e arbitrazhit kishte filluar me datë 13.04.2015, pothuajse 2 muaj pasi që i akuzuari Agron është caktuar Kryeshef Ekzekutiv, dhe përkundër shumë kërkesave e ka lejuar që lënda të shkojë në arbitrazh për çka e ka angazhuar kompaninë “S...” e cila ishte e afërt me të akuzuarin Agron, që t’i përfaqësojë në procedurën e arbitrazhit, dhe më pas edhe pse nuk lejohej ankesa ndaj vendimit të arbitrazhit, i njëjti ka parashtruar ankesë e me këtë është detyruar të paguaj shpenzimet e krijuara. Gjithashtu Prokuroria thekson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka fal besimin raporteve financiare ku përcaktohet dëmi i shkaktuar sipas vendimit të arbitrazhit dhe procedurës para dhe pas vendimit. Sipas Prokurorisë të gjitha provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor dëshmojnë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj i propozon Gjykatës së Apelit që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

Në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë Speciale të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit E.Q., avokati Elmi Qerimi, theksohet se Prokuroria në ankesën e saj nuk ofron asnjë provë të re, vetëm përsërit argumentet e paraqitura në aktin akuzues dhe fjalën përfundimtare. Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për gjendjen faktike. Andaj, propozon që ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë Speciale të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit A.M., avokati Artan Qerkini, theksohet se gjykata e shkallës së parë me të drejtë konstaton se nuk ka ekzistuar dashja për të kryer vepër penale, si element qenësor i veprës penale nga neni 422 të KPRK-së. I akuzuari M. me rastin e marrjes së detyrës nuk ka pas mundësi tjetër që të veproj përpos që të respektoj rekomandimet e profesionistëve të zyrës ligjore se a i takojnë apo jo shërbimet 3G apo 4G Kompanisë Z Mobile, në të kundërtën do të përballëshin me veprime të kundërligjshme lidhur me kërkesat e Z Mobile për shërbimet 3G dhe 4G dhe numeracionin shtesë. Sa i përket përgjegjësisë, ishte zyra ligjore ajo që e interpretonte kontratën dhe nëse i akuzuari do të vepronte në të kundërtën do të tejkalonte autorizimet e tij dhe do të rrezikonte kryerjen e veprës penale, si dhe do të ishte jo reale që të pritej prej tij të zgjidhte problemin brenda vetëm dy muajve që kishte marr detyrën. Sa i përket pretendimit të prokurorisë lidhur me tenderin për përfaqësimin e PTK-Vala që e kishte fituar Kompania S..., se kjo kompani është e afërt me të akuzuarin M. nuk gjen mbështetje në asnjë provë, si dhe procedura e tenderimit nuk ishte një burimore siç pretendon prokuroria se siç shihet nga vendimi i OSHP, në këtë tender ka marr pjesë edhe Operatori Ekonomik Deloitte dhe tenderi ka shkuar sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik. Andaj, propozon që ankesa e Prokurorisë Speciale të refuzohet si e pabazuar.

Në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë Speciale të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit R.GJ., avokati Teki Bokshi, thekson se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës dhe se nuk ka asnjë shkelje esenciale që Gjykata e Apelit e trajton sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka trajtuar të gjitha provat e propozuara nga organi akuzues dhe se nga

ato prova nuk dëshmohej fajësia e të akuzuarit GJ.. Ankesa e Prokurorisë nuk ka vë në dyshim në asnjë pjesë aktgjykimin e atakuar. I akuzuari GJ. si Kryetar i Bordit, e po ashtu edhe anëtarët e bordit nuk kanë pas kompetencë ekzekutive, por kjo ishte kompetencë ekskluzive e Kryeshefit Ekzekutiv. Në asnjë mbledhje të Bordit nuk është ngritur çështja e sim kartelave në mënyrë të Bordi të merr ndonjë vendim lidhur me këtë çështje e kjo për shkak se ka qenë në kompetencë e Kryeshefit Ekzekutiv. Andaj, i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën e Prokurorisë Speciale.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, janë të bazuara pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe se aktgjykimi i ankimuar tani për tani është i pa qëndrueshëm, ngase i njëjti përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, e në lidhje me nenin 370 par. 7 të KPPRK-së, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara. Nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse, me ç'rast i ka pamundësuar marrjen e vendimit të drejtë.

Gjykata e Apelit gjen se sipas aktakuzës si pika kryesore që të tre të akuzuarit si zyrtar udhëheqës të PTK-së, akuzohen për mos përmbushjen e kontratës 01-156/09 të datës 16.01.2009 të lidhur në mes të Telekomit të Kosovës dhe D....net L.L.C (Z mobile), më saktësisht për vonesën e liferimit të sim kartelave, mos furnizimin me bllokun e numeracionit dhe mos dhënies së shërbimeve 3G dhe 4G. Dy të akuzuarit e parë E.Q. dhe A.M. në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së për periudha të ndryshme sa kishin ushtruar këtë funksion, ndërsa i akuzuari i tretë R.GJ. në cilësinë e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve. I akuzuari A.M. gjithashtu akuzohet se duke mos e parandaluar arbitrazhin ka angazhuar kompaninë “S...” si kompani e afërt me të, në procedurë tenderimi një burimor, që ta përfaqësoj PTK-në në procedurën e arbitrazhit, si dhe duke e ditur që nuk lejohet ankesa në vendimin përfundimtar të arbitrazhit, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Lartë Angleze ndaj vendimit të arbitrazhit, ndërsa edhe i akuzuari R.GJ. akuzohet se ka lejuar ankesën ndaj vendimit përfundimtar të arbitrazhit.

Duke mos vepruar, respektivisht duke mos përmbushur kontratën, të akuzuarit i kanë mundësuar Kompanisë “D....net” që të parashtroj padë në arbitrazh ndërkombëtar, ku pas procedurës së arbitrazhit është marr vendim që Kompanisë D... ti paguhen 32,856,407.28 euro dëmshpërblim dhe urdhërimi për përmbushjen e kontratës, si dhe lidhur me procedurën para dhe pas arbitrazhit, PTK është dëmtuar në shumë prej 5,049,681.69 euro dhe 60,000.00 GBP (funte) si shumë e pagesës së Kompanisë për përfaqësim ligjor dhe shpenzime tjera.

Gjykata e Apelit pjesërisht pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Shkallës së parë, megjithatë jo tërësisht, çka e bënë aktgjykimin të paqëndrueshëm në tërësi, për faktin se në përshkrimin e

gjendjes faktike janë të përfshira të gjitha mos veprimet që është dashtë të ndërmerren nga të akuzuarit, por që nuk janë dhënë arsye të qarta për disa nga to.

Sipas shkresave të lëndës rezulton se i akuzuari E.Q. ka qenë Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së nga data 24.02.2012 gjer me datë 01.10.2014, i akuzuari A.M. ka qenë Kryeshef Ekzekutiv nga data 23.02.2015 gjer në fillim të vitit 2018, ndërsa i akuzuari R.GJ. ka qenë Kryesues i Bordit nga mesi i vitit 2008 gjer në fund të vitit 2016.

Gjithnjë, sipas shkresave të lëndës dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor Kompania D... pretendon se shërbimet 3G dhe 4G si dhe vonesa në liferimin e sim-kartelave burojnë nga kontrata e parë e lidhur në mes PTK-së dhe D....net me datë 16.01.2009, ndërsa rezervimi i numeracionit të numrave të ri, rezulton se i janë rezervuar D...it (Z Mobile) me vendimin e ARKEP numër 381 të datës 18.07.2013. Ndaj këtij vendimi ishte bërë padi me propozim për masë të përkohshme nga PTK, ku Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datë 05.08.2013 e kishte refuzuar kërkesën për masë të përkohshme, ndërsa Gjykata e Apelit me datë 27.11.2013 e kishte vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Andaj, nga data 27.11.2013 rrjedh obligimi për respektimin e vendimit të ARKEP-it.

Sa i përket shërbimeve të 3G dhe 4G, Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë konstaton se lidhur me këto shërbime Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv kanë qenë të këshilluar nga Drejtori i Departamentit Ligjor S.R., si zyrtar kompetent për këtë çështje, se sipas kontratës D... nuk e ka të drejtën e këtyre shërbimeve. Këtë çështje e ka konfirmuar dhe vet dëshmitari S.R. në dëshminë e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, por edhe në deklaratat e tij të mëhershme. Pra, ishte Drejtori i Departamentit Ligjor si jurist i Ndërmarrjes PTK që ka interpretuar kontratën në atë mënyrë dhe se duke pas parasysh se asnjëri nga të akuzuarit nuk janë jurist, ishte plotësisht e logjikshme se të njëjtit nuk kanë pas si të veprojnë ndryshe, përveç që të zbatojnë rekomandimin e Drejtorit R., sepse do të mund të ndiqeshin penalisht nëse nuk do ta zbatonin rekomandimin në fjalë po që se do të rezultonte e kundërta. Në anën tjetër, çdo kontest civil ngritët kur dy palë kundërshtare kanë qasje të kundërt në një raport juridik detyrimor apo interpretim të kundërt të marrëveshjeve, për çka gjykata e zgjidhë çështjen, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret.

Sa i përket liferimit të sim-kartelave Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i qartë. Është evidente se sipas kontratës, PTK ka marr obligim për liferimin e sim-kartelave, ndërsa për këto PTK i ka dhënë me vonesë prej 534 ditëve për porosi që janë bërë në vitin 2010, 2011 dhe 2013. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se kjo ka qenë obligim i personit juridik PTK e jo i të akuzuarve, është jo i qëndrueshëm. Çdo person juridik varet prej veprimeve të personave përgjegjës, ndërsa të akuzuarit kanë qenë udhëheqës të PTK-së si person juridik. Më tej në aktgjykimin e ankimuar theksohet se nëse kanë ndodhur vonesat kjo ka

ndodhur si rezultat se PTK është furnizuar me sim-kartela nga M..., ndërsa PTK e ka furnizuar D... dhe se D... ka pasur kartela “spare” – rezervë për furnizimin e konsumatorëve. Gjykata e Apelit gjen se kjo nuk është e mbështetur në ndonjë provë të besueshme e për më tepër Gjykata e Arbitrazhit në vendimin e saj nuk e përmend në asnjë pjesë se kemi të bëjmë me kartela rezervë, por me obligimin që e kishte PTK në liferimin e sim-kartelave.

Gjykata e shkallës së parë fare nuk i referohet vendimit përfundimtar të arbitrazhit lidhur me çështjen e vonesave të liferimit të sim-kartelave. Në këtë vendim Gjykata e Arbitrazhit në mënyrë të detajuar shpjegon mbrojtjen e të paditurit – PTK-së gjatë seancave në arbitrazh lidhur me liferimin e sim-kartelave. PTK si e paditur kishte dhënë arsye të shumta pse nuk i kanë liferuar sim-kartelat me kohë, por asnjëra nga to nuk kishte pas bazë të arsyeshme dhe se nuk kanë pasur ndikim që të ketë vonesa siç është theksuar në vendimin e arsyetuar të arbitrazhit. Njëra nga këto arsye ishte ajo që theksohet në aktgjykimin e ankimuar, se vonesat kishin ndodh pa fajin e PTK-së, sepse vareshin nga M.... kur bëhej fjalë për ekzekutimin e kërkesës për liferim të sim-kartelave. Por, siç rezulton nga aktgjykimi i arbitrazhit, ky nuk ishte pretendim i bazuar sepse nuk kishin prezantuar asnjë provë në procedurë të arbitrazhit¹ për këtë çështje e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është prezantuar ndonjë provë që e dëshmon se vonesat janë bërë pa fajin e PTK. Për këtë aktgjykimi i ankimuar nuk shpjegon se në çka bazohet apo cila është ajo provë që e dëshmon se faji për vonesa është i ndërlidhur me vonesat nga M....

Sa i përket liferimit të sim-kartelave, duhet që sqarohet edhe pozicioni i të akuzuarit A.M., për faktin se i njëjti nuk ka qenë Kryeshef Ekzekutiv në kohën kur pretendohet për vonesat e liferimit të sim-kartelave. Vendimi i arbitrazhit flet për vonesat në kërkesa të bëra në vitin 2010, 2011 dhe 2013, ndërsa i akuzuari M. ka marr detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv në shkurt të vitit 2015. Nga përshkrimi i gjendjes faktike në pikën e aktakuzës ndaj të akuzuarit M., rezulton se i njëjti akuzohet edhe për vonesën e liferimit të sim-kartelave për periudhën sa nuk ka qenë në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv.

Lidhur me ndarjen apo rezervimin e numeracionit jo-gjeografik për Operatorin Virtual D....net LLC nga ARKEP me vendimin numër 381 të datës 18.07.2013, arsyetimi në aktgjykimin e ankimuar është plotësisht i paqartë dhe në kundërshtim të plotë me vendimin përfundimtar të arbitrazhit. Në aktgjykimin e ankimuar jepet shpjegim se plani kombëtar i numeracionit të telefonisë si dhe furnizimi i operatorëve telefonik me pjesë të tij si bllok i numeracionit është veprim ekskluziv i rezervuar për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit – ARKEP, sipas ligjit 04/L-109 mbi Komunikimet Elektronike, dhe se vendimi i ARKEP me numër 381 është realizuar ku PTK sh.a. kishte marr bllokun e numeracionit 377 45 7xx xxx prej 100.000 numrave. Por, kjo nuk rezulton të jetë e saktë sipas shkresave të lëndës.

¹ Vendimi Përfundimtar OEN me numër 20990/MHM, Pika 93, faqe 33 versionit shqip.

ARKEP në vendimin e saj të datës 18.07.2013 ka rezervuar serinë e numeracionit jo-geografik mobil 0457xxxxx, për operatorin virtual “D...net”. Ndaj këtij vendimi PTK ka parashtruar padi me propozim për masë të përkohshme, ku Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin A.nr.1034/13 të datës 05.08.2013 e ka refuzuar propozimin, ndërsa duke vepruar sipas ankesës së PTK-së, Gjykata e Apelit në aktvendimin A.A.nr.284/2013 të datës 27.11.2013 ka refuzuar ankesën duke e vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Pra, nga data 27.11.2013 rezulton obligimi për PTK-në që ta zbatoj vendimin e ARKEP. Por, siç rezulton kjo nuk ka ndodhur. Në këtë kohë Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së ishte E.Q. deri në tetor 2014. Ndërsa nga shkurti 2015 Kryeshef Ekzekutiv ishte A.M.. Gjatë tërë kësaj kohe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të PTK-së ishte R.GJ.. Siç rezulton nga shkresat e lëndës që të tre të akuzuarit kanë qenë në njohuri të vendimit të ARKEP si dhe të vendimeve të Gjykatës.

Nga vendimi përfundimtar i arbitrazhit rezulton se PTK qëllimisht nuk i kishte dhënë këto numra Kompanisë D..., sepse paraqiste konkurrencë të drejtpërdrejtë të paditurit – PTK-së dhe do të rrezikonte qëndrueshmërinë e tyre në treg. Për më tepër gjatë seancave të arbitrazhit është dëgjuar edhe i akuzuari R.GJ. si Kryetar i Bordit në cilësinë e dëshmitarit për të paditurin (PTK), ku i njëjti kishte deklaruar se *“njëri nga interesat primar dhe orientues i PTK-së ishte të kishte një biznes të suksesshëm dhe nëse rezervimi i 100,000 numrave shtesë nga ART-ja për PTK-në nuk ishte në pajtim me këtë orientim, atëherë numrat nuk do të jepeshin”*. Gjithashtu ishte dëgjuar edhe Arben Shabani si dëshmitar për të paditurin (PTK) ku kishte deklaruar se *“i padituri (PTK) kishte ngurrime për t’i alokuar numra shtesë paditësit (D... – Z Mobile) pasi që do të krijonte shpenzime të pambuluara”*.²

Sipas vendimit përfundimtar, i padituri – PTK, në përmbledhjen pas dëgjimore theksohet se *“[i padituri] ka të drejtë ta mbroj vetveten kundër një MVNO-je³ e cila... në mënyrë të përhershme konkurron me të paditurin duke e dëmtuar, që është në kundërshtim me kontratën përkatëse, vullnetin e mirë të biznesit të telekomunikimit të paditurit”*. Ndërsa përsëri sipas dëshmisë së të akuzuarit GJ., i njëjti kishte deklaruar se *“operatori virtual në esencë nuk mund ta rrezikoj një kompani siç është Telekom i Kosovës me 200,000 konsumator”*⁴. Në fund, lidhur me të gjitha pretendimet e paditësit (D...net – Z Mobile) për mos përmbushjen e kontratës nga i padituri (PTK), pra sa i përket mos dhënies së shërbimeve 3G dhe 4G, vonesat në liferimin e sim-kartelave, mos dhënien e numeracionit sipas vendimit të ARKEP, si dhe zvogëlimin e cilësisë së shërbimeve, vendimi përfundimtar i arbitrazhit gjen se janë bërë me qëllim⁵.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë fare nuk merret me vendimin përfundimtar të arbitrazhit, me gjetjet e saj dhe provat që i ka administruar dhe vërtetuar si të sakta. Por, as

² Vendimi Përfundimtar OEN me numër 20990/MHM, Pika 104, faqe 37 versionit shqip.

³ Operatori Virtual, në rastin konkret Z Mobile.

⁴ Vendimi Përfundimtar OEN me numër 20990/MHM, Pika 156, faqe 56 versionit shqip.

⁵ Vendimi Përfundimtar OEN me numër 20990/MHM, Pika 157, faqe 56 versionit shqip.

Prokuroria Speciale nuk i jep rëndësi vendimit të arbitrazhit me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve relevant dhe të akuzuarve për zbulimin e dashjes, por vetëm e lexon si provë materiale që të përcaktoj shumën e përcaktuar si dëm dhe konstatimin që e shpallë përgjegjës PTK-në si të paditur. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar në një rën anë jep arsye që nuk kemi të bëjmë me vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ndërsa në anën tjetër thekson se nuk ekziston dashja për të kryer këtë vepër. Gjykata e Apelit gjen se mosekzistimi i dashjes nuk mund të arsyetohet nëse nuk ekziston vepra penale, por vetëm nëse është kryer kjo vepër, ndërsa nëse përmbushen elementet e kësaj vepre, e njëjta kryhet me dashje dhe jo nga pakujdesia dhe vetëm atëherë arsyetohet ekzistimi apo mos ekzistimi i dashjes.

Sa i përket parandalimit të procedurës së arbitrazhit që kryesisht i ngarkohet të akuzuarit A.M., Gjykata Apelit gjen se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i qartë. Sipas aktgjykimit të ankimuar kjo pjesë nuk mund ti ngarkohet të akuzuarit M. për shkak se procedura e arbitrazhit kishte filluar para se i njëjti ta merr detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv. Por, sipas shkresave të lëndës rezulton se padia në arbitrazh është parashtruar me datë 13.04.2015 si datë e fillimit të procedurës së arbitrazhit, ndërsa i akuzuari M. pozitën e kishte marr me datë 23.02.2015. Gjykata e shkallës së parë për këtë rrethanë e mbështetet në deklaratat e të dëmtuarve B.D. dhe M.GJ. të cilët kishin deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor se procedura e arbitrazhit ka filluar para se të merr pozitën i akuzuari M.. Por, padia e parashtruar me datë 13.04.2015 është në kundërshtim me deklaratat e të dëmtuarve dhe këtë gjykata e shkallës së parë nuk e sqaron fare, se çka nënkuptojnë të dëmtuarit me fillimin e procedurës së arbitrazhit, se si mendojnë të dëmtuarit se procedura ka filluar para se të merr i akuzuari M. detyrën apo edhe nëse do të stoponin apo pezullonin të dëmtuarit këtë procedurë, nëse do të jepeshin shërbimet dhe numrat e ri nën udhëheqjen e të akuzuarit M..

Sa i përket angazhimit të Kompanisë “S...” nga i akuzuarit A.M. si tender një burimor, Gjykata e Apelit pajtohet me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë si të sakta. Gjykata e Apelit gjen se Prokuroria Speciale nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të dëshmonte afërsinë e Kompanisë Studio Ligjore “Ligji” me të akuzuarin M.. I vetmi informacion që ekziston për këtë afërsi të pretenduar është deklarata e të akuzuarit A.M. në Polici, se pas përfundimit të tenderit ka kuptuar se pronar i kësaj Kompanie është N.K. të cilin e kishte njoh në kohën kur ka punuar në Aeroport. Ndërsa pretendimi se tenderi ka qenë një burimor, rezulton të mos jetë i saktë, duke pas parasysh se Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte nxjerr vendimin PSH.nr.273/15 të datës 29.08.2015, duke refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik “DE..” SHPK si të pabazuar dhe duke e vërtetuar vendimin e PTK-së për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime Profesionale Ligjore”, Operatorit Ekonomik Studio Ligjore “Ligji” SHPK. Nga ky vendim shihet qartë se në procedurën e tenderimit kanë aplikuar dy kompani - “DE..” SHPK dhe Studio Ligjore “Ligji” SHPK, por që Kompania “DE..” ishte eliminuar për shkak të mos përmbushjes së kushteve të tenderit dhe këtë veprim e ka pranuar edhe OSHP duke e pranuar

raportimin e ekspertit shqyrtues. Pra, këtë pjesë të akuzës ndaj të akuzuarit A.M. edhe Gjykata e Apelit e pranon si arsyetim të gjykatës së shkallës së parë.

Sa i përket lejimit të parashtrimit të ankesës ndaj vendimit përfundimtar të arbitrazhit duke e ditur se nuk lejohet ankesa e që ngarkohen të akuzuarit A.M. dhe R.GJ., Gjykata e Apelit gjen se ky veprim nuk përbën vepër penale. Të njëjtit kanë qenë të këshilluar nga Kompania e angazhuar e avokatëve që të parashtrojnë ankesë, si dhe ky ishte vendim kolektiv i Bordit të Drejtorëve në bazë të këshillimeve me avokatë. Gjithashtu, në rastin e vendimit me të cilin kanë pësuar humbje, të njëjtit si palë kanë pas të drejtë që të shfrytëzojnë çfarëdo rruge apo mënyre që të gjejnë mundësi për rishikim të vendimit. Andaj, Gjykata e Apelit edhe për këtë pjesë të akuzës gjen se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të drejta.

Gjykata e Apelit konkludon se pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale lidhur me liferimin e sim-kartelave dhe numeracionit janë të bazuara, ndërsa sa i përket shërbimeve 3G dhe 4G, si dhe procedura e tenderimit për përfaqësimin e PTK-së në arbitrazh dhe ankesës ndaj vendimit të arbitrazhit nuk janë të bazuara.

Nga të lartcekurat aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqëndrueshëm, andaj edhe është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, pasi që në kuptim të nenit 403 të KPPRK-së, Gjykata e Apelit nga konstatimet e bëra lidhur me shkeljet e lartcekura nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund të korrigjoj duke ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar. Andaj, në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet dhe konstatimet e lartcekura duke i administruar të gjitha provat dhe ti vlerësoj ato në pajtim me nenin 361 duke dhënë arsyetim për çdo provë kundërthënëse sipas nenit 370 të KPPRK-së, të shqyrtoj dhe të vlerësoj provat kundërthënëse në raport me vendimin përfundimtar të arbitrazhit, të nxjerr transkriptet e seancave të arbitrazhit ku janë dëgjuar apo lexuar dëshmitë e dëshmitarëve, të vlerësoj pretendimet e PTK-së në procedurën e arbitrazhit nga dokumentet e listuara në vendimin përfundimtar të arbitrazhit në faqen 10 si parashtrësia të paditurit, në raport me provat tjera të administruara, të vlerësoj përgjegjësinë e të akuzuarve në vendimmarrjen e tyre lidhur me vonesën në liferimin e sim-kartelave dhe mos respektimin e vendimit të ARKEP-it, të vlerësoj dëmin e shkaktuar dhe kujt i është shkaktuar dëm, përkatësisht të vlerësoj se sipas nenit 19 paragrafi 1 pika 1.7 dhe 1.14 a ka pësuar dëm edhe PTK-ja nga veprimet e të akuzuarve dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim të drejt dhe ligjor.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 402 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.1/2020 me datë 15.04.2020

Zyrtari ligjor

Bajram Rexhahmetaj

Anëtarët e kolegjit

Kreshnik Radoniqi

Vaton Durguti

Kryetari i kolegjit

Burim Ademi